MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
Nr. 850
Datë.më 24.02.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E DREJTËSISË**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MONITORIMIT**
**DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROFESIONEVE TË LIRA**
**SEKTORI I MONITORIMIT TË VEPRIMTARISË NOTERIALE**

Nr. B-8/4 Prot. Tiranë, më 17/02/2026

Lënda: Njoftohet urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 90, datë 12.02.2026, "Për heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit, noteres Bernereta Bedini".

**MINISTRISË SË MBROJTJES**
**MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME**
**MINISTRISË SË FINANCAVE**
**MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**
**MINISTRISË SË ARSIMIT**
**MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT**
**MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**
**MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MIRËQËNIES SOCIALE**
**MINISTRISË SË MJEDISIT**
**MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT**
**MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME**
**MINISTRISË SË SHTETIT PËR MARRËDHËNIET ME PARLAMENTIN**
**MINISTRIT TË SHTETIT PËR PUSHTETIN VENDOR**
**MINISTRIT TË SHTETIT PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE ANTIKORRUPSIONIN**
**MINISTËR SHTETI DHE KRYENEGOCIATOR**
**AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS**
**AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË PRONAVE**
**AVOKATURËS SË PËRGJITHSHME TË SHTETIT**
**TIRANË**
**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR**

**GJYKATËS SË LARTË**
**GJYKATËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**
**GJYKATËS SË APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË**
**GJYKATËS SË APELIT ADMINISTRATIV TIRANË**
**GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË LUSHNJE**
**GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM BERAT**

Bulevardi "Zogu I-rë", Tiranë Tel: + 355 4 2259 390 http://www.drejtesia.gov.al info@drejtesia.gov.al

GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DIBËR
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DURRËS
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
ELBASAN
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
FIER
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
GJIROKASTËR
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KUKËS
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
LEZHË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
SARANDË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
SHKODËR
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË
GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
VLORË

**BANKËS SË SHQIPËRISË**
Sheshi Skënderbej 1, Tirana
**BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE**
Rr. e Kavajës, Nr. 27/1, Njësia Administrative 10, K. P. 1001, Tiranë, Shqipëri
**BANKËS CREDINS (BC)**
Adresa: Rr. "Ismail Qemali", nr. 21
**BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË (BBSH)**
Adresa: Rruga e "Durrësit", godina 14 katëshe "Tekno Projekt"
**BANKËS SË PARË E INVESTIMEVE, SHQIPËRI SH.A. (BPI)**
Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 14-15
**BANKËS INTESA SANPAOLO- SHQIPËRI (BIS)**
Adresa: Rr. "Ismail Qemali", Nr. 27
**BANKËS KOMBËTARE TREGTARE (BKT)**
Adresa: Blv. "Zhan D`Ark"
**BANKËS OTP BANK**
Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla I, Kati 9
**BANKËS PROCREDIT (BPC)**
Adresa: Rr. "Dritan Hoxha", Nd.92, H.15
**BANKA RAIFFEISEN**
Adresa: Blv. Bajram Curri, European Trade Center (ETC)
**BANKËS TIRANA (BT)**
Adresa: Rr. "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Kutia Postare 2400/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E DREJTËSISË SEKRETARIA

**BANKËS UNION (BU)**
Adresa: Blv. "Zogu i I", Pallati 13 katësh, përballë Stacionit të Trenit,Tiranë

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PËRMBARIMIT**
Adresa: Sheshi "Mustafa Qemal Ataturk", Tiranë

**AGJENCISË SË INTELIGJENCËS FINANCIARE**
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.3, Tiranë

**QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT**
Bulevardi "Zhan D'Ark",Prona nr.33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë

Të nderuar,

Ju njoftojmë se, me Urdhrin nr. 90, datë 12.02.2026 të Ministrit të Drejtësisë është vendosur heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit, noteres Bernereta Bedini, në bazë gërmës "a", të pikës 1 të nenit 21, të ligjit nr.110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar.

Duke ju falënderuar,

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Geron Ibrahimi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E DREJTËSISË -



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E DREJTËSISË - SEKRETARIA -

Nr. B-8/2 Prot. Tiranë, më 12.02/2026

**URDHËR**

**Nr. 90, Datë 12.02.2026**

**"PËR HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT, NOTERES BERNERETA BEDINI"**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, të nenit 6, të nenit 7 pikës 2 të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të nenit 21, pika 1, shkronja "a", dhe nenit 67 të Ligjit Nr. 110/2018 "Për noterinë", nisur nga administrimi i kërkesës së noteres Berenta N.Bedini për heqje dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit, administruar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. B-8 prot., datë 20.01.2026,

**KONSTATOJ:**

Noterja Bernereta N.Bedini, e cila ka fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të noterit bazuar në Lejen nr. 3462 datë 19.06.2001 të Ministrit të Drejtësisë *"Për dhënien e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit dhe përcaktimin e njesisë vendore të ushtrimit të veprimtarisë noteriale"*, ka paraqitur kërkesën e saj për heqje dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit.

Ligji Nr. 110/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar, në nenin 21, gërma "a", parashikon heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit përmes Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë, kur noteri heq dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit, me kërkesën e tij.

Sipas nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar dhe konkretisht pikës 1 dhe 2 të tij, në rast të mbylljes së përkohshme ose të përhershme të një zyre noteriale, arkivi i noterit në largim merret nga noteri që plotëson vendin vakant. Nëse një vend vakant mbetet i paplotësuar, dega vendore përkatëse e Dhomës përzgjedh një tjetër noter në atë bashki për të marrë përsipër arkivin, në bazë të përzgjedhjes me short. Dega vendore përkatëse mund të zgjedhë një noter të propozuar nga noteri në largim. Në çdo rast, noteri i zgjedhur ka për detyrë të marrë përsipër arkivin.

Sa më sipër, nisur nga administrimi i kërkesës së noteres Bernereta N.Bedini, për heqjen dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit, si dhe në respektim të parashikimeve të akteve ligjore e nënligjore në fuqi për noterinë, dhe në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, të nenit 6, nenit 7 pikës 2, të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë",

i ndryshuar, të nenit 21, pika 1, shkronja "a", dhe nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar,

**URDHËROJ:**

**1.** Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noteres Bernereta N.Bedini, anëtare e Degës Vendore të Noterisë Elbasan, për shkak të heqjes dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit.

**2.** Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

a.) Znj. Diana Toro, specialiste pranë Ministria e Drejtësisë;
b.) Znj. Majlinda Lato, notere e caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Durrës;
c.) Znj. Nurie V. Gjorga, anëtare e Degës Vendore Durrës me ushtrim të veprimtarisë noteriale në Elbasan.

**3.** Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noteres Bernereta N.Bedini, nga Komisioni i caktuar në pikën 2, të këtij urdhri.

**4.** Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij urdhri Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë dhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykata Administrative e Apelit, Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe bankat e nivelit të dytë.

**5.** Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noterial, si dhe të evidentojë çdo mungesë dhe dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.

**6.** Ndaj këtij urdhri, noteri mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të tij.

**7.** Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.

**8.** Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Monitorimit pranë Ministrisë së Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dega Vendore e Noterisë Durrës, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.

**9.** Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Monitorimit pranë Ministrisë së Drejtësisë, për njoftimin e këtij urdhri noteres Bernereta N.Bedini, Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Degës Vendore të Noterisë Durrës.

**10.** Ngarkohet Drejtoria TIK në Ministrinë e Drejtësisë për të çaktivizuar ish-noteren, si përdoruese të sistemit RNSH, si dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë nga sistemi NISA.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Besfort Lamallari**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E DREJTËSISË